



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.11.2019, ora 10:45

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i 3 procesverbaleve për mbledhjet e komisionit në datat: 07, 11 dhe 15 tetor 2019
- Shqyrtimi i nismës së deputetit z. Ilir Beqja për propozimin e projektligjit "Për faljen e gjobave të vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj operatorëve të biznesit ushqimor"

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Reme Lala, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita dhe Ylli Shehu, Antoneta Dhima

Mungojnë:

Vullnet Sinaj.

Të ftuar:

Nismëtari

1. z. Ilir Beqja

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

1. Znj. Ermira Gjeçi – Zevendes Minister
2. Z. Alban Mesonjesi – Drejtor Juridik MBZHR
3. Z. Robert Lili - Drejtor i Pergjithshem AKU

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përsëndetje!

Mediet kanë 2 minuta kohë që të stabilizohen dhe të mbajnë qetësi.

A ka ndonjë koment për pikën e parë të rendit të ditës lidhur me procesverbalet e mbledhjeve të komisionit të datave 7, 11 dhe 15 tetor 2019? Nuk ka.

Atëherë, zyrtarisht konsiderohen të miratuara.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Për shkak se është nismë specifike, do ta ndërrojmë rendin e të prezantuarit. Ftoj zotin Ilir Beqaj dhe më pas unë, si relator, do të mbaj qëndrimin tim.

Zoti Ilir, ju lutem.

Ilir Beqaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, kolege dhe kolegë!

Në periudhën korrik - gusht të këtij viti, në përmbushje të misionit të saj, por edhe si një përpjekje e gjithanshme e qeverisë për të rritur sigurinë ushqimore në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve, si dhe të drejtave të tyre si konsumatorë, AKU-ja ka konstatuar moszbatim të ligjit dhe po sipas ligjit ka vendosur gjoba. Ky aktivitet i AKU-së, në qoftë se ju kujtohet, përkoj edhe me diskutimin që ne bëmë në Kuvend për ndryshimet në Kodin Penal, pikërisht për ndryshimet në funksion të sigurisë ushqimore, por e bashkërenduar edhe me një përpjekje të qeverisë në shumë sektorë në mënyrë të koordinuar për të rregulluar moszbatimin e ligjit. Gjatë kësaj periudhe unë, si deputet, kam marrë ankesa nga subjekte të ndryshme. Këto subjekte ishin ndodhur në një situatë, të cilën deri diku unë e quaj paradoksale, ku ishin ballafaquar me kushtet e moszbatimit të ligjit për 10 vjet, që do të thotë se VKM-ja, që rregullon pajisjet e caktuara me licencë, e cila është në fuqi që nga viti 2009, nuk kishte ndryshuar. Me sa duket, AKU-ja në atë moment ka qenë më kapilare në evidentimin e moszbatimit të ligjit dhe, sigurisht, çdo inspektor, nëse nuk vepron kur konstaton se ka moszbatim të ligjit, bëhet përgjegjës para ligjit. Ka një parim të përgjithshëm juridik që mosdija nuk është justifikim para ligjit, por, në gjykimin tim, duke qenë se mosdija paska qenë kaq masive dhe kaq e shtrirë në kohë, AKU-ja mund të kishte vepruar edhe në mënyrë më të lehtë, sepse çdo inspektim që kryhet nuk ka detyruesisht gjobë, ka edhe larmi detyrash, ka

edhe riinspektim. Megjithatë, kjo është zgjedhja e tyre, sepse ashtu e kanë gjykuar edhe në frymën e përgjithshme që mbizotëroi në muajt korrik dhe gusht. Për më tepër, nga të dhënat që unë kam marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në shumicën dërrmuese subjekteve në atë periudhë e morën licencën brenda 2 apo 3 javëve, që do të thotë se nuk iu shmangën ligjit për të mos shpenzuar në teknologji, por ishte më shumë një çështje administrative me dokumente. Fakti që në muajt korrik-gusht në QKB kërkesat për këtë licencë kanë qenë 10 herë më të larta se muajt korrik-gusht të vitit 2018, si dhe fakti që deri në atë kohë kur unë jam marrë me këtë nismë, 75% e kërkesave ishin pranuar, unë gjykoj se çështja ka qenë nga mosnjohja si dhe nga moskërkesa insistuese e trupave inspektuese ndër vite për këtë çështje. Duke qenë se subjektet ishin vendosur me shpejtësi para kësaj situate në muajin gusht situata u zbut, sepse shumica e bizneseve e morën vesh që në korrik që duhej kjo licencë, ndaj aplikuan dhe e morën. Kështu, pati një rënie të nivelit të gjobave, pasi, me sa duket, u vendosën në ligjshmëri. Ndaj, unë propozoj që gjobat e vendosura në periudhën nga data 1 korrik të vitit 2019 deri më 31 gusht të vitit 2019, kur ishte edhe masivi i inspektimeve dhe vendimeve të paligjshmërisë nga AKU-ja, të falen. Sigurisht, nga muaji shtator e më tej unë nuk e kam ndjekur më procedurën se si ka vazhduar AKU-ja me këto subjekte, por shumica dërrmuese e subjekteve e panë që mungonte kjo licencë apo këto licenca sipas këtyre dy kategorive, ndaj shkuan dhe i morën dhe, praktikisht, u vendosën konform me ligjin. Më pas besoj se rregullimi i neneve është i përshkruar këtu, por nuk më duket e arsyeshme të flas për nenin, pasi të gjithë e kanë para.

Zoti Kryetar, kolege dhe kolegë, ky ishte parashtrimi im për këtë projektligj. Sigurisht, jam i gatshëm që t’iu përgjigjem pyetjeve që mund të keni.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Besoj se do të vazhdojmë me logjikën që unë si relator do të mbaj qëndrimin tim zyrtar, më pas do të vazhdojmë me pyetje apo komente, në qoftë se do të keni, por, nga çfarë unë kuptoj, nuk besoj se do të ketë shumë.

Atëherë, nga analizimi i kujdesshëm i projektligjit “Për faljen e gjobave të vendosura nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj operatorëve të biznesit ushqimor” evidentohen disa problematika si më poshtë:

1. Problematika lidhur me kategorinë e subjekteve përfituese sipas propozimit. Qëllimi dhe objektivi i projektligjit, sipas nenit 1 të tij, është falja e gjobave të subjekteve, të cilët janë dënuar

nga AKU-ja, bazuar në nenin 68, pika 1, shkronjat “e”, “g” dhe “i” të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Bazuar në dispozitat e evidentuara në nenin 1 të projektligjit rezulton se gjobat, që propozohen të falen, janë vënë për shkeljet e konstatuara, konsistojnë në:

Zhvillimin e biznesit në një stabiliment të peregjistruar. Për këtë shkelje, sipas nenit 68, pika 1, shkronja “e” të ligjit të sipërcituar, masa e gjobës varion në intervalin nga 1 milion deri në 2 milionë lekë.

Veprimet në kundërshtim me kërkesat e vetëkontrollit, sipas propozimit të zotit Beqaj, megjithëse u janë referuar të tri pikave, kryesisht kanë pasur në fokus zhvillimin e biznesit të një stabiliment i peregjistruar. Pra, logjika është fokusuar te shkronja “e”, por në propozimi ai ka përfshirë edhe dy shkronjat e tjera.

Sa më sipër, operatorët ekonomikë, që prek apo që pretendohet të përfitojnë nga ky projektligj, nuk janë vetëm operatorët që zhvillojnë biznesin në një stabiliment të peregjistruar/të pa licencuar lidhur me veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme. Sipas nenit 1 të projektligjit, përfitojnë, gjithashtu, edhe operatorët që kanë kryer veprime në kundërshtim me kërkesat e vetëkontrollit (heqja nga tregu e ushqimeve të importuara, prodhuara, përpunuara, shpërndarë apo nxjerrë në treg, që nuk janë në përputhje me kërkesat e sigurisë ushqimore apo që dëmtojnë shëndetin e njerëzve), si dhe operatorët që kanë kryer veprime në kundërshtim me kërkesat e gjurmueshmërisë, që lidhen me krijimin e një sistemi/bazë të dhënash dhe garantojnë procedurat, të cilat mundësojnë identifikimin në çdo çast në të gjitha nivelet e prodhimit, të përpunimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, të lëndëve të para me origjinë bimore ose shtazore, kafshët, që prodhojnë ushqim ose kafshët e përdorura në prodhimin e ushqimeve, përfshirë gjurmimin e çdo substance tjetër, të përcaktuar për të bashkëvepruar ose që ka bashkëvepruar me ushqimin. Pra, janë të gjitha në një objektiv për sigurinë ushqimore në favor të qytetarëve,

Ndërkohë, sipas relacionit dhe nenit 2 të projektligjit, të propozuar nga zoti Beqaj, nga kjo falje përfitojnë të gjitha subjektet, të cilat janë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, por në momentin e inspektimit nuk kanë qenë të pajisura me licencën për “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë të ushqimeve”, me kodin II.1.A; dhe licencën për “Shitje me shumicë të ushqimeve me origjinë shtazore”.

Për sa më sipër, përcaktimet e nenit 1 nuk janë harmonizuar me frymën e projektligjit në përgjithësi, kjo duke pasur në konsideratë përcaktimet e nenit 2 të tij.

2. Premisa për antikushtetueshmëri për shkak të cenimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Gjobat e propozuar për t'u falur, sipas këtij projektligji, i përkasin periudhës dymujore 01.07.2019 deri 31.08.2019. Në relacionin që shoqëron projektligjin, nuk jepet ndonjë informacion se përse nga e gjithë gama e shkeljeve të evidentuara nga AKU-ja ndër vite zgjidhen për t'u falur vetëm shkeljet e sanksionuara në segmentin kohor 1 korrik- 31 gusht 2019, kur shkelje të tilla mund të jenë kryer ndër vite dhe nga shumë subjekte të tjera, të cilat kanë paguar ose jo, por që nuk përfshihen në gamën e subjekteve përfituese të faljes sipas projektligjit të propozuar.

Theksojmë se ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin” si dhe VKM-ja nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, kanë hyrë në fuqi prej shumë vjetësh tashmë dhe evidentimi nga AKU-ja i llojit të shkeljeve të përcaktuara në nenin 1 dhe 2 të projektligjit, por edhe i shumë shkeljeve të tjera të parashikuara nga ligji për ushqimin, është pjesë e punës së përditshme të këtij institucioni. Ky segmentim i periudhës përfituese dhe i tipologjisë së shkeljeve, në këndvështrimin tim, pa një argumentim bindës, krijon premisën për antikushtetueshmëri për shkak të cenimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës, për shkak se është selektiv dhe favorizues i një kategorie specifike operatorësh ekonomikë, bën trajtim të pabarabartë dhe diferencues midis operatorëve që kanë kryer të njëjtën shkelje në kohë të ndryshme, por edhe midis operatorëve të tjerë, të cilët kanë kryer shkelje të natyrave të ngjashme, të parashikuar nga ligji. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, si një parim i rëndësishëm kushtetues, është trajtuar gjerësisht edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila shprehet, si më poshtë: “Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllojta për individë ose kategori personash, që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve, që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara, që përfitojnë nga kjo e drejtë, mund të përligjet vetëm në raste

përrjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive”. Po të shikoni vendimin, ato që janë cituar në relacionin e projektligjit të propozuar, nuk përfshihen te rastet përrjashtimore.

Sa më sipër, për shkak se projektligji objekt shqyrtimi nuk siguron apo sanksionon trajtimin e barabartë të individëve që janë në kushte të barabarta, vlerësohet se është në kushtet e cenimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Ndërkohë, për sa i përket cenimit të parimit të së drejtës që “padijenja e ligjit nuk të përrjashton nga përrgjegjësia” unë nuk dua ta detajoj, pasi asnjë nga ne nuk është i pafajshëm në aspektin ligjor, nëse nuk e dimë ligjin që ka 1 ditë apo 10 vjet që ka dalë dhe është aktiv.

Pa u zgjatur në detaje teknike, është edhe ajo që teknikisht ne i referohemi si “*moral hazard*” në administrimin publik. Për qytetarët “*moral hazard*” prezupozohet se është një instrument nëpërmjet një ligji ose një nënligji apo një procedure që krijon premisa tek entitetet dhe subjektet që të mos zbatojnë ligjin me idenë se një ditë mund të falen. Unë u mundova ta shpjegoj në mënyrë më të thjeshtë që ta kuptojnë të gjithë qytetarët.

Së fundi, periudha për të cilën i referohet propozimi është periudha kur qeveria dhe Kryeministri kanë ndërmarrë një fushatë antiinformaliteti me theks sigurinë ushqimore për qytetarët. E thënë kjo, për të gjitha problematikat e evidentuara më sipër, vlerësoj se projektligji i propozuar nuk duhet të miratohet, ndaj sugjeroj dhe u kërkoj anëtarëve të komisionit mosmiratimin e tij.

Faleminderit!

Me lejen e komisionit, unë dua të bëj një pyetje për zëvendësministren dhe për drejtorin e Përrgjithshëm të AKU-së.

Së pari, a keni dijeni për këtë projektligj? A keni ju një qëndrim zyrtar? Pyetjet janë për ju, zonja Zëvendësministre, dhe më pas mund të përrgjigjet edhe drejtori.

Ermira Gjeçi - Mirëdita të gjithëve dhe faleminderit!

Ne jemi njoftuar lidhur me këtë projektligj dhe qëndrimi ynë zyrtar...

Arben Ahmetaj – Më falni, a jeni njoftuar apo jeni në dijeni të materies së projektligjit?

Ermira Gjeçi – Jemi njoftuar.

Arben Ahmetaj – A jeni njoftuar, apo jeni në dijeni të materies së projektligjit?

Ermira Gjeçi – Po, jemi në dijeni.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ermira Gjeçi – Qëndrimi ynë është për mosaprovimin e këtij projektligji. Sikurse edhe ju përmendët, AKU-ja ka qenë duke ushtruar funksionet e saj gjatë periudhës në të cilën ka kontrolluar operatorët e biznesit ushqimorë me një vendim të Këshillit të Ministrave, i cili ka qenë në fuqi që nga viti 2009. Periudha së cilës i referohet ky projektligj është korrik –gusht, ku janë 51 subjekte të gjobitura, por gjatë vitit 2019 totali i subjekteve të gjobitura për të njëjtën arsye është afërsisht 80, që do të thotë se një pjesë trajtohen dhe një pjesë nuk trajtohen.

E dyta, ligji nuk parashikon paralajmërim të bizneseve, por është shumë i qartë kur thotë: “Nëse subjekti kapet me shkelje në mungesë të QKL-së gjobitet dhe gjoba varion nga 1 deri në 2 milionë lekë”.

Arben Ahmetaj – Zonja zëvendësministre, ju lutem mos përsërisni argumentet e relatorit. Qëndrimi juaj si qeveri është kundër aprovimit të këtij amendamenti, po apo jo?

Ermira Gjeçi – Po, jemi kundër aprovimit të këtij projektligji.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, nuk kam nevojë për asnjë koment tjetër nga qeveria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Artur Roshi – Pyetjen e kam për zëvendësministren. Qeveria a ka në plan të shtojë gamën e faljeve për gjobat e tjera adresuar bizneseve të llojeve të ndryshme, përfshirë edhe rastin konkret që vjen nga zoti Beqaj?

Arben Ahmetaj – Më falni, zonja zëvendësministre ju keni qenë shumë shpesh në komision, prandaj duhet ta merrni fjalën me leje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që duhet t’i përgjigjeni pyetjes së zotit Roshi, por, ju lutem, kërkoj mirëkuptimin tuaj që të fokusohemi tek amendamenti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rrezikojmë të dalim nga tema, megjithatë fjala për ju, zonja zëvendësministre.

Ermira Gjeçi – Qëndrimi ynë, si përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, ashtu sikurse ishte edhe sot, është kundër për këto gjoba specifike. Nuk mund t’ju përgjigjem direkt për këtë pyetje, por nga ana tjetër dua të them se çdo subjekt i gjobitur, i cili e gjykon që gjoba nuk ka qenë e drejtë dhe korrekte, në rrugë administrative bën ankimimin te komisioni, i cili shqyrton ankimimin brenda një periudhe të caktuar kohore dhe, nëse përsëri ngelet i pakënaqur, atëherë i drejtohet gjykatës.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Kam një pyetje për zëvendësministren apo për drejtorin e Përgjithshëm të AKU-së...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, specifikojeni për kë do ta bëni pyetjen.

Blerina Gjylameti – Pyetja është për drejtorin e Përgjithshëm të AKU-së, por, nëse nuk e ka si informacion, meqenëse ka një periudhë kohore të shkurtër në detyrë, atëherë mund të përgjigjet zëvendësministrja. Dua të di, nga të gjitha gjobat që janë vendosur në këtë periudhë apo edhe në periudha të mëparshme, sa prej tyre janë apeluar dhe sa kanë rënë nga komisioni?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kush do të përgjigjet? Po, zoti drejtor.

Robert Lili – Nga janari deri në shtator të vitit 2019 gjobat që janë vënë për licencim të subjekteve në total janë 79, ku në korrik janë vendosur 22 gjoba, në gusht janë vendosur 30 gjoba dhe në shtator janë vendosur vetëm 3 gjoba. Të gjitha gjobat e korrikut dhe të gushtit janë apeluar pranë institucionit tonë, por edhe në gjykatë. Ne kemi ngritur komisionin për shqyrtimin e ankimit të këtyre gjobave dhe jemi brenda afateve ligjore, por për arsye të kompleksitetit të gjobave, sepse gjoba nuk është vënë vetëm për arsye të mospasjes së licencës, por edhe për shkelje të tjera që janë gjetur në subjekt, si mungesë e kushteve të gjurmueshmërisë, të etiketimit dhe për probleme të skadencës së mallit, duhet bërë ndarja e këtyre gjobave nga gjobat që janë vendosur vetëm për mospasjen e licencës. Pra, jemi në shqyrtim administrativ dhe brenda nëntorit do të marrim përgjigje, sepse janë vetëm 52 gjoba për moslicencim në periudhën korrik – gusht dhe në vazhdim.

Arben Ahmetaj – Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Pyetja ime nuk ishte vetëm për gjobat e vendosura për licencimin, por për të gjitha gjobat e vendosura. Në përgjigjen tuaj numri total i gjobave të vendosura nga AKU-ja ishte 79, gjatë periudhës janar – shtator dhe vetëm 15 janë për licencimin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse keni mundësi a mund ta detajoni pak më shumë informacionin për gjobat e vendosura nga AKU-ja, mbi çfarë baze janë vendosur? Sa gjoba janë për pjesën e propozimit të kolegut Beqaj dhe sa prej tyre brenda afateve duhet të ishin rishqyrtuar nga komisioni që keni pranë institucionit tuaj?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, ju lutem.

Robert Lili – Edhe një herë për informacion, nëse nuk u dëgjua apo nuk u kuptua, nga periudha janar – shtator të vitit 2019 janë vendosur në total 79 gjoba për mospasje të licencës. Nga këto në muajin korrik janë vendosur 22 gjoba, në gusht janë vendosur 30 gjoba dhe në muajin shtator janë vendosur 3 gjoba për moslicencim. Po flas vetëm për pjesën e moslicencimit.

AKU-ja gjatë gjithë vitit dhe çdo ditë të vitit kryen inspektime të planifikuara në bazë të planit kombëtar vjetor të kontrolleve, të marrjes së mostrave dhe të vendosjes së masave administrative në kushtet e shkeljes flagrante që kapen dhe trajtohen në terren subjektet. Pra numri total i gjobave të AKU-së që po kërkon zonja deputete është një numër që nuk i përket këtij projektligji, por janë statistika të tjera. Ne po flasim vetëm për gjobat e vendosura në mungesë të QKL-së.

Arben Ahmetaj – Me lejen e zonjës Gjylameti, po e përsëris pyetjen, sepse kam përshtypjen që nuk u morëm vesh. Sa gjoba të tjera, jo vetëm të shkronjës “e”, por edhe të shkronjës “g” dhe shkronjave të tjera keni vënë deri më sot dhe brenda kësaj periudhe? Pra jo thjeshtë për licencimin. Ju lutem, nëse mundeni t’i shpjegoni komisionit çfarë do të thotë licencim në këtë rast?

Robert Lili – Materialin për gjobat në total të vendosura nga AKU nuk e kemi për momentin që flasim, por kemi vetëm atë pjesë që është trajtuar për gjobat e vendosura në mungesë licence.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ju lutem, mbani pak qetësi. Zonjë, mos e ngrini më dorën, sepse radha është juaja dhe zoti Roshi nuk jua merr radhën, aq më tepër që ai tregon respekt të përmbajtur ndaj jush.

Pra, po thoni që nuk e dini numrin e gjobave që institucioni juaj ka vendosur për pika të tjera të ligjit në referencë të shkeljeve të tjera përveç licencimit, a është kështu?

Robert Lili – Nuk po them se nuk e di, por informacionin që po kërkohet nuk e kemi të disponueshëm në këtë moment.

Arben Ahmetaj – A mund të na e thoni nëse e dini?

Robert Lili – Nuk e disponoj informacionin.

Arben Ahmetaj – Nuk e dispononi?

Robert Lili – Nuk e disponoj, sepse kemi ardhur vetëm për pjesën e gjobave për licencim.

Arben Ahmetaj – Nuk ka gjë, nëse e dini, mos e dërgoni me shkrim na e thoni sot.

Robert Lili – Kjo është një statistikë, sepse çdo ditë të punës sonë vendosim gjoba.

Arben Ahmetaj – Nuk ka gjë më thoni deri në datën 1 tetor.

Robert Lili – Nuk e jap dot, sepse nuk e kam si informacion.

Arben Ahmetaj – Më fal se nuk po e kuptoj nuk e dini apo nuk e keni?

Robert Lili – Nuk e kam informacionin.

Arben Ahmetaj – Është e qartë. Dakord. Zonja Gjylameti, kur ta dijë drejtori, do t’jua dërgojë.

Blerina Gjylameti – Në informacionin që do të na dërgoni, ju lutem, përtej totalit të gjobave të vendosura, pjesa e dytë e pyetjes ishte se sa gjoba ishin ankimuar dhe sa janë rrëzuar nga komisioni, jo vetëm për licencencimin, por për të gjitha. Në këtë mënyrë, informacioni që ne kemi në bazë të një nga fushatave antiinformalitet, por dhe të sigurisë kombëtare do të jetë më i plotë për ne si deputetë, përtej qytetarëve.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zonja zëvendësministre, informacionin e dua brenda ditës së premtë për komisionin zyrtarisht nga ju.

Drejtori ka dhe një pjesë të pyetjes që nuk është përgjigjur për komisionin, çfarë do të thotë licencim, në bazë të shkronjës “e”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, zoti Beqaj, sa të përgjigjet drejtori.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka gjë, zoti drejtor, na e dërgoni edhe këtë definicion me shkrim kur ta keni.

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Nëse mundem ...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, dua pak qetësi. Zonja Gjylameti, a mund të mbani qetësi në respekt të kolegut?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Xheili, a keni ndonjë merak që doni ta shprehni përpara se të flasë zoti Beqaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Roland Xhelili – E konsideroj që ka një lloj transparence dhe qëndrimi real të drejtorit të Përgjithshëm, sepse është i ri në detyrë dhe ka një njohje minimale vetëm për ...

Arben Ahmetaj – Jo, jo nuk na prish punë fare, sepse do të na e dërgojë me shkrim.

Roland Xhelili – Unë mendoj të mos e vendosim në presion për numrin total të gjobave nga janari...

Arben Ahmetaj – Zoti Xhelili, në bazë të Rregullores së Kuvendit, ne si komision i kërkuam informacion. Nëse ju e quani presion, atëherë është presion pozitiv. Besoj se jemi dakord.

Roland Xhelili – Po, jemi dakord.

Arben Ahmetaj – Pra biem dakord për togfjalëshin “presion pozitiv”

Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Të nderuar kolegë, nëse mundem pa cenuar Rregulloren e Kuvendit dhe mënyrën e funksionimit të komisionit tuaj, të mundohemi të fokusohemi te amendamenti. Unë jam i bindur për secilin nga ju, por dhe për vete, që çështjet e sigurisë ushqimore janë me shumë interes dhe pyetjet për ministrinë mund të jenë 360 gradë. Nëse është e mundur, të mbarojmë me amendamentin dhe pastaj ju mund të vazhdoni vetë me ministrinë.

Arben Ahmetaj – Je shumë i saktë dhe i drejtë, faleminderit, zoti Beqaj, që na orientove.

Po, zonja Edlira.

Edlira Hyseni – Unë po i drejtohem me pyetje nismëtarit, meqenëse mund të ketë informacion më të saktë. Unë jam dakord me projektligjin që ju propozoni, sepse unë jam pro faljes. Në gjykimin tim, në përgjithësi biznesi ka nevojë për të pasur pak frymëmarrje dhe një amnisti fiskale që do të përfshinte një spekter më të gjerë dhe kjo do të ishte shumë e mirëpritur. Pra, unë jam favoruese dhe miratuese e këtij projektligji për sa kohë mund t’i japë një dorë, mbështetje dhe frymë biznesit, i cili në këtë kohë fushate informaliteti po i vuan pak penaltetet.

Periudhën që keni përfshirë në amendament është korrik – gusht, por unë jam e idesë, nëse ky projektligj do të kalojë, të kishte efekt deri më sot, përderisa për atë lloj penalteti nuk ka gjoba vetëm në periudhën korrik – gusht, ose ta shtrijmë nga janari deri më sot.

Unë dua t’ju pyes konkretisht, meqenëse bëhet fjalë për 52 subjekte, sepse 52 gjoba që janë vënë për periudhën korrik – gusht, sipas informacionit që na dha drejtori, a keni ndonjë informacion më të saktë se sa është efekti financiar? Këtu nuk kemi ndonjë përfaqësues të Ministrisë së Financave, por këto 52 gjoba në çfarë vlere përkthehen? Ne jemi Komisioni i Ekonomisë dhe për të kuptuar vlefshmërinë duhet parë shifra materiale, pra çfarë efekti financiar

ka në buxhet kjo shifër dhe sa është shifra, të paktën me përafërsi për 52 gjobat. Nëse marrim 79 gjobat në total nga janari deri në shtator, sa do të ishte vlera totale e 79 gjobave? E para.

E dyta, ju thatë se 75% e subjekteve që janë penalizuar kanë aplikuar për licencim dhe u është miratuar kërkesa në vijim. Por nëse do të kalonte ky projektligj, atëherë do të ishte mirë që të ishte kushti për faljen e gjobave, të ishte licensimi i subjekteve, sepse ata mund të vazhdojnë aktivitetin në informalitet, se gjoba u fal dhe presin kur të kapen herën tjetër. Pra, të jetë kusht që gjoba do të falet nëse bizneset të kenë marrë licencën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kanë marrë, sepse vetëm 75 % e tyre kanë aplikuar, ne nuk e dimë sa është totali i kërkesave dhe sa janë pranuar. Pra, unë jam për idenë që afati i faljes të shtrihet nga janari deri kur ligji të hyjë në fuqi dhe dua të di se çili është efekti financiar në total i tyre?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Së pari, kjo nismë është depozituar në datën 13 shtator, prandaj nuk mund të parashikojë deri më 31 tetor, sepse nuk kishte ndodhur, aq më shumë që hiteri parlamentar është jashtë vullnetit, dëshirës apo kontrollit të deputetit propozues apo çdo deputeti tjetër, sepse ajo vendoset në Konferencë Kryetarësh me konsensus ose në seancë me votë.

Nuk kam bërë llogaritje aritmetike të vlerës së gjobës, sepse jam nisur me parimin, siç e kam thënë edhe në relacion, nga 1 korriku deri më 31 gusht për arsye licence kanë aplikuar 1415 subjekte, që do të thotë se prej vitesh ata kanë qenë në moszbatim të ligjit. Moszbatimi i ligjit paska qenë kaq masiv sa deri më 30 qershor ka qenë një gjë e pranuar në mënyrë të heshtur, e pa vënë re në mënyrë mikroskopike nga vetë administrata e AKU-së në vite.

Meqë mora fjalën, me ato që parashitroi kolegu Ahmetaj në qëllimin e tij, unë jam dakord me pjesën e kushtetutshmërisë, ato janë parime të përgjithshme. Si deputet dhe si qytetar ndiej rrezikun e përhapjes së **mora lazer**, por shifrat më bëjnë të ndalem. Pra, 1415 subjekte kanë qenë në paligjshmëri, që do të thotë trupat inspektuese i kanë lënë me qëllim? E bënë me qëllim që të bënë presione të paligjshme për t'i zhvatur apo është vlerësuar kjo lloj licencë në mënyrë ekuivoke? Për ta thënë praktikisht, në muajin korrik përfaqësuesit e AKU-së kanë shkuar te një që prodhon hamburger dhe i kanë thënë: “Hamburgeri është proces prodhimi ushqimor, sepse mishi që grihet, përziehet me qepë e me vaj dhe që ngrohet është prodhim ushqimor prandaj duhet të kesh

një licencë”. Ajo është trupa që ne i kemi dhënë mandatin për ta bërë këtë gjë. Edhe institucionet i rrisin kapacitetet e tyre dhe në atë moment mund ta kenë gjykuar kështu. Në gjykimin tim duhet të mos kishin vendosur automatikisht gjobë. Zëvendësministria thotë: “Ligji është i qartë, po të konstatova, të gjobis” dhe unë si punonjës pajtohem me këtë, sepse konstatimi dhe mosgjobitja më bën mua prezent përpara ligjit.

Për t’ju përgjigjur juve, nuk e di se sa është vlera, por me sa di, këta e dinë më mirë le ta korrigjojnë, por nuk është më pak se 10 milionë lekë të vjetra një gjobë, ashtu e kemi të vendosur gjobën në ligj. AKU-ja e ka për detyrë ta zbatojë ligjin, sepse nuk e ka gjobën me diskrecion, me interval...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di, mund të jetë edhe 20, por me sa di unë, është jo më pak se 10 milionë. Ndërkohë, për të qenë të barabartë përpara ligjit, po këta 1415 subjekte minus 52 që nuk u gjobitën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk u erdhi koha, sepse nuk mund të kontrollosh 50 subjekte në ditë. Vërtet ne po krijojmë një regjim të pabarabartë dhe po falim disa gjoba, por shifrat tregojnë se 1415 subjekteve minus 52 duhej vendosur gjobë, por ata nuk kanë marrë gjobë dhe kjo krijon pabarazi.

Arben Ahmetaj – Po.

Suzana Topi – Pyetja ime është për zëvendësministren e Bujqësisë. Unë dua të di nëse ka laboratorë të licencuar për të bërë kontrollin e produkteve ushqimore, madje dhe bujqësore? E para.

Arben Ahmetaj – Më fal, patjetër që do t’i përgjigjesh zonja zëvendësministre, por ju lutem, kolegë, fokusohuni te projektligji..

Suzana Topi – Dakord, vetëm këtë pyetje, nuk po e bëjmë të dytën.

Arben Ahmetaj – Zonja zëvendësministre, përgjigjuni, ju lutem!

Ermira Gjeçi – Pjesa e laboratorëve nuk ka lidhje me licencimin ose me pjesën e gjobave. Mendoj se pyetja juaj nuk lidhet me çështjen që po diskutojmë sot.

Arben Ahmetaj - Zonja zëvendësministre, ju nuk jeni këtu për të gjykuar komisionin. Komisioni ju bëri një pyetje dhe ju keni detyrim të jepni përgjigje, jo ta anashkaloni. Detyrimi juaj është të thoni: po, ka, dhe janë 1, 2, 3, 4, ose: jo, nuk ka, dhe mbaron përgjigjja. Nuk mund të gjykoni pyetjen e deputetit.

Ermira Gjeçi – Dakord.

Ju lutem, mund ta përsërisni edhe një herë pyetjen?

Arben Ahmetaj – Po e përsëris unë.

A ka laboratorë të licencuar që i referohen të gjitha çështjeve që prek siguria ushqimore?

Ermira Gjeçi - Po, ka laboratorë të licencuar.

Arben Ahmetaj – Sa?

Ermira Gjeçi – Janë të akredituar.

Është Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe i Veterinarisë, që janë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë; janë laboratorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të cilët janë në funksion të analizave, të përcaktuara ...

Arben Ahmetaj – Janë të akredituar?

Ermira Gjeçi – Akreditohen instituti, laboratorët dhe testet. Flasim për tri tipologji të ndryshme akreditimi. Ka edhe laboratorë privatë, por unë nuk e disponoj këtë informacion.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Na e dërgoni me shkrim, nëse e doni, zonjë, apo jo?

Ju lutem...

Ermira Gjeçi – Ne kemi informacion nga laboratorët privatë, pasi nuk kërkojnë leje nga Ministria e Bujqësisë që të jenë në *database*-n e informacionit që disponojmë. Unë mund ta marr një informacion, por nuk do të jetë informacion zyrtar. Për aq kohë sa jemi në dijeni zyrtarisht lidhur me institucionet e varësisë dhe me laboratorët e Ministrisë së Bujqësisë, patjetër që do t’jua jap.

Arben Ahmetaj – Ju po thoni se Ministria e Bujqësisë nuk është e informuar për laboratorët privatë të akredituar në Republikën e Shqipërisë, që garantojnë sigurinë ushqimore nëpërmjet punës së tyre?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, sapo tha Albani që e ka.

Pse e ka?

Jo që ta dish, sepse ti e di, por mos u impresiono nga opozita.

Ermira Gjeçi – Jo.

Arben Ahmetaj – Ditën kur atyre laboratorëve u vendoset vula, ti i njeh nëpërmjet AKU-së dhe i ke në sistem.

Ju lutem, dërgojeni informacionin brenda ditës së premte!

Faleminderit!

Zonja Senida.

Senida Mesi - Përshëndetje!

Meqenëse po kërkojmë informacione, jam plotësisht dakord me elementin e riskut, rrezikut moral apo të ashtuquajtur *moral hazard*, pasi nuk mund të insentivojmë sjellje në kundërshtim me ligjin, duke falur gjobat.

Arben Ahmetaj – Mund të mbani qetësi, pasi po flet zonja Senida?

Senida Mesi – Nëse do ta bënim, do të krijojmë atë që kishim deri në vitin 2013, individë dhe biznese që shkelin ligjin, por e dinë që në një moment shkelja e ligjit dhe implementimi i gjobave, do t'u falet, kurse të tjerët që respektojnë ligjin, janë konform tij, nëse nuk respektojnë, paguajnë gjobat. Pra, të themi një diferencë, ku hajde të shkelim ligjin, sepse në një moment të dytë, nuk e di për cilën arsye, shteti, qeveria, parlamenti, do të na i falë gjobat. Kjo histori për mua është mbyllur në vitin 2013 dhe nuk duhet të përsëritet.

Kur flasim për numrin e gjobave, pra, sa gjoba kemi vendosur, qofshin administrative, për hapje apo jo të licencave, qofshin edhe për elemente të sigurisë ushqimore, unë dua të di sa janë këto gjoba sot dhe punën e AKU-së për të parandaluar nesër rrezikun e rënies së cilësisë ushqimore? Sa kanë ndikuar këto gjoba që ne të kemi një cilësi ushqimore të shtuar, për të garantuar publikun që puna e inspektorëve të AKU-së ku në themel është ligji. Besoj se asnjëri nga inspektorët, por as qeveria, nuk kanë për synim vendosjen në vetvete të gjobave. Sigurisht, kur gjenden në paligjshmëri do të implementohen të gjitha shkeljet administrative, por vlerësimi i riskut është shumë i rëndësishëm. Unë do t'ju rekomandoj dhe do t'ju kërkoj, që në raportin që do të na sillni ne të bëni një vlerësim të riskut në QKB. Ju mund të merrni lehtësisht licencat e të gjitha subjekteve që janë të lidhura me subjektet që ju kontrollojnë, për të kontrolluar nëse licencat primare kryesore për hapjen e biznesit, shitjen me pakicë, hamburger apo restorante, e kanë të bashkëngjitur licencën e dytë, që është licencë profesionale e kategorisë së përcaktuar edhe në projektligjin e miratuar. Është lehtësisht e verifikueshme me dy kolona sa nga subjektet në Republikën e Shqipërisë, subjekte të AKU-së janë të licencuara në QKB dhe sa prej tyre, që në bazë të ligjit duhet ta kenë licencën, e kanë apo jo?

Më pas do të shkoj te rekomandimi i kolegut Beqaj për të dërguar një letër informuese, për t'u thënë: në 10 vjet, 2 apo 5 vjet jeni në paligjshmëri. Ne do të vijmë për kontroll dhe nëse në momentin e kontrollit nuk do t'i keni këto licenca, do t'ju implementohet gjobë. Janë

ndërgjegjësuar 1400, por ndoshta mund të jenë edhe 2 mijë apo 3 mijë në Shqipëri që duhet të kenë licencën e dytë profesionale.

Do t'ju lutesha ta bënit tani këtë, që ne të mos gjendemi në një moment të dytë në diskutimin: duhet apo nuk duhet vendosur kjo gjobë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Senida!

Meqenëse nuk ka më pyetje, do të jap një qëndrim si relator.

E falënderoj kolegun tim, zotin Beqaj!

Dua të theksoj edhe një element që e përmendi zoti Beqaj, që mund të ketë pasur në shkelje të ligjit biznese dhe persona të tjerë juridikë apo fizikë. Kjo është detyrë e AKU-së. Parlamenti nuk bën detyrën e AKU-së. Është detyrë e AKU-së të zbatojë ligjin, të penalizojë ata që janë në shkelje të ligjit. Siguria ushqimore është primare për shëndetin e qytetarëve. Ky parlament nuk duhet të zbusë kurrë qasjen e vet ndaj shkelësve të çdo lloji, por sidomos të sigurisë ushqimore. Në të gjitha sondazhet që bën jo vetëm qeveria, por edhe aktorë të shoqërisë civile, siguria ushqimore është primare. Herën tjetër do të ishte e denjë për këtë komision që të thërrisnim AKU-në bashkë me Ministrinë e Bujqësisë. Ta caktojmë pas buxhetit, në janar ose në shkurt, për të bërë një diskutim të hapur, për të parë si është bërë puna dhe çfarë duhet bërë; si duhet forcuar ligji, çfarë nevojash ka Ministria e Bujqësisë, çfarë nevojash ka AKU-ja, ku ka çeduar puna, ku ka ecur puna, a ka nevojë për ndryshime ligjore, a ka nevojë për më shumë informacion, në mënyrë që elementi i sigurisë ushqimore të vijë jo thjesht si një kërkesë e procesit të integritetit evropian, por sepse ka të bëjë drejtpërdrejt me shëndetin e qytetarëve.

Faleminderit!

Zoti Beqaj, ti i the ato që kishe.

Të falënderoj, sepse thatë se nuk kishit kohë, pasi kishin një takim tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Votojmë në parim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Rrëzohet.

Nuk kemi nevojë të kalojmë nen për nen, sepse e kemi rrëzuar në parim.

Zoti Beqaj, faleminderit për kontributin e vazhdueshëm me amendamente!

Jam i bindur që do të dilni deputeti me më shumë amendamente të propozuara, ndoshta edhe të rrëzuara, por nuk ka rëndësi, pasi është kontribut.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti